



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.039/2016

Prishtinë, më 23 shtator 2016,

P R O C E S V E R B A L

Mbledhjen e kryesoi Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje morën pjesë: Salihe Mustafa, Nenad Rashiq, Mexhide Mjaku-Topalli, Etem Arifi, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu, Valdete Bajrami dhe Kujtim Paçaku.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit (UNICEF).

Pjesëmarrës të tjerë: Hajrudin Skenderi-Swiss Embassy, Ukë Gashi-ZPRK, Eugen Cakolli-KDI, Sanije Berisha-OSBE dhe Florina Ujupi-BIRN.

Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit, i hapi punimet e mbledhjes së sotme, sipas propozimit të rendit të ditës të paraqitur dhe të dërguar anëtarëve të Komisionit.

Anëtarët e Komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit FunkSIONAL, andaj në vazhdim Komisioni i zhvilloi punimet me këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme;
2. Rishikimi i Planit të punës për vitin 2016;
3. Kërkesa për bordin e AKP-së lidhur me çështjen e ish -punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore “Sharr-Sallonit” nga Hani i Elezit;
4. Të ndryshme.

Para se të fillohet me shqyrtimi e pikave të rendit të ditës, deputetja, Teuta Haxhiu, ngriti shqetësimin rreth sigurimit të incizimit të tryezës, së mbajtur më 29 gusht 2016, për shënimin e Ditës Ndërkombëtare për Personat e Zhdukur - rasti i Kosovës, sepse është një çështje që kam kërkuar edhe në prezencë të z. Ibrahim Makolli.

Kjo, nga se, siç tha ajo, rezolutat dhe rekomandimet në bazë të kryetares së Komisionit dhe z. Makolli, janë dokumente që nuk obligojnë qeverinë e Republikës së Kosovës.

Unë mendoj që është e kundërta, andaj kërkoj nga zyra ligjore e Kuvendit interpretim për ta sqaruar këtë çështje.

Lirije Kajtazi- Tha se incizimin e tryezës do ta keni, qëndroj prapa asaj që kam thënë për efektin juridik të rezolutës dhe rekomandimeve. Për mua është gjithçka e qartë dhe për më shumë mundemi të kërkojmë përgjigjeje në instanca më të larta.

Nenad Rashiq- Tha se sa i përket rekomandimeve apo rezolutave, nuk kanë ndonjë peshë se e obligojnë qeverinë të punojë në atë drejtim. Ai propozoi që për të gjitha rezolutat apo rekomandimet që dalin nga takimet tona mund ta bëjmë një radhitje, ku ne mund të kërkojmë shpjegime prej institucioneve relevante pas 6 muajve, se çka është ndërmarr prej miratimit të atij dokumenti, mendoj se kjo i mban në përgjegjësi institucionet.

Salihe Mustafa- Tha se kur kemi miratuar raportin për monitorimin e ligjit për personat e verbër, rekomandimi i fundit është që në afat prej 6 muajve MPMS, MASHT dhe MSH, në bashkëpunim me Shoqatën e Personave të Verbër, të nënshkruajnë një Marrëveshje të Përbashkët për zbatimin e nenit 10.3 të Ligjit për Personat e Verbër.

Në të ardhmen do të duhej, si Komision, të bëjmë një praktikë në lidhje me përcjelljen e zbatimit ose jo të rekomandimeve të miratuara.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme

Kryetarja konstatoi se procesverbali, i mbledhjes së datës 31 gusht 2016, u miratuan pa asnjë vërejtje të anëtarëve të Komisionit.

Mexhide Mjaku-Topalli, në lidhje me vërejtjet e bëra nga ajo, në mbledhjen e dt. 31 gusht 2016, për procesverbalet e datës 30 qershor 2016 dhe 12 korrik 2016, tha se ishte një çështje e natyrës teknike. Pas konsultimeve me stafin e administratës së Komisionit, ajo tha se është konstatuar se gjithçka është në rregull dhe se ato procesverbale mund të procedohen më tutje.

2. Rishikimi i Planit të punës për vitin 2016

Lirije Kajtazi, në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, tha se, siç dihet Kuvendi nuk ka arritur të përmbushë agjendën legjislative, e cila çështje, po ashtu, ndërlidhet edhe me punët në komisione.

Kemi disa projektligje që janë në kompetencë të Komisionit tonë. Një projektligj në lexim të parë i është kthyer Qeverisë, një e kemi në procedurë, por që është proceduar me vonesë në Kuvend nga Qeveria.

Ajo, më pas, hapi diskutimet lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Mexhide Mjaku Topalli- Tha se si Komision qëndrojmë mirë në realizimin e planit të punës për vitin 2016.

Ka qenë kërkesë e të gjithë anëtarëve të Komisionit që të bëhet një vizitë studimore për Projektligjin për të drejtat e fëmijëve, për të analizuar praktikat më të mira dhe shpresojmë se kjo vizitë do të realizohet në muajin tetor.

Ajo vuri në pah se kanë mbetur pa u realizuar edhe vizitat në institucionet korrektuese të Kosovës dhe kjo duhet realizuar në javët në vazhdim.

Kujtim Paçaku diskutoi në lidhje me vizitat e realizuara, të anëtarëve të Komisionit në Njësitë për të drejtat e njeriut nëpër disa komuna, për të cilat vizita tha se kanë dhënë rezultat.

Në të ardhmen është mirë të ketë sa më shumë anëtarë të Komisionit ose i tërë Komisioni, të cilët do të merrnin pjesë në këto vizita, sepse nga ajo që ka ndodhur në këto raste, ka rezultuar se kanë marrë pjesë një numër më i vogël i anëtarëve të Komisionit.

Ai foli edhe për vizitat studimore të cilat do të na kishin ndihmuar shumë që të realizohet sa më mirë ky plan i punës, por edhe në aspektin e të drejtave të fëmijëve të mbrojtjes së komuniteteve etj.

Lirije Kajtazi- Tha se me vizitat në Njësitë për të drejtat e njeriut nëpër komuna, jemi në proces dhe për këtë ende nuk kemi finalizuar ndonjë rekomandim.

Mytaher Haskuka- Tha se sa i përket projektligjit për mbrojtjen e fëmijës duhet të kemi kujdes të shikojmë me vëmendje vërejtjet që kanë sjellë organizatat e ndryshme, të mbajmë një punëtori të përbashkët me këto organizata, në mënyrë që të bëjmë një ligj sa më të mirë në favor të fëmijëve.

Sa i përket ankesave të shumta që kanë punëtorët për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, lidhur me të drejtat e tyre të përcaktuara është mirë të kemi një debat me përfaqësues të AKP-së, dhe të informohemi me arsyet pse janë duke u vonuar pagesat.

Në lidhje me mbikëqyrjen e rekomandimeve që dalin nga raporti i vitit 2015, të Institucionit të Avokatit të Popullit, kjo është e paraparë në muajin nëntor. Mirëpo ai u interesua të dijë rreth formës së asaj mbikëqyrjeje, përmes formimit të ndonjë grupi punues apo në formë tjetër.

Lirije Kajtazi, gjatë shqyrtimit të raportit vjetor të IAP, jemi munduar që të kemi debat në Kuvend, por për ta plotësuar këtë ne kemi lënë këtë mundësi që edhe ne, si Komision, të kontribuojmë për zbatimin e këtyre rekomandimeve, në një mbledhje tjetër akordohemi për formën se si do të bëjmë mbikëqyrjen e rekomandimeve të IAP.

Mexhide Mjaku-Topalli, sa i përket rekomandimeve të IAP, ajo ngrit çështjen e njohjes së statusit të dëshmorëve para vitit 1999, gjë që ka qenë rekomandim edhe i Avokatit të Popullit për njohjen e këtij statusi.

Ajo theksoi se pajtohet që për këtë çështje të takohemi në muajin nëntor dhe të diskutojmë për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre rekomandimeve.

Teuta Haxhiu: Për mosrealizimin e planit të punës tha se është edhe përgjegjësi e qeverisë, nga se shumë prej Projektligjeve janë bartur nga legjislatura e kaluar.

Sa u përket peticioneve, ajo tha se në vazhdimësi kemi pranuar peticione si Komision. Ne i shqyrtojmë e i dëgjojmë palët, por në fund, kemi shumë pak hapësirë për t'u dhënë zgjidhje.

Ajo u interesua të dijë se çka është bërë me Propozim-udhëzuesin për shqyrtimin e peticioneve. Në fund, ajo u interesua të dijë nëse në Komision ka ardhur peticioni i 205 mijë qytetarëve.

Etem Arifi- Tha se Komisioni në masë të madhe ka arritur që t'i përmbush objektivat që dalin nga plani i punës.

Sa u përket rekomandimeve që ka bërë Komisioni, ai ishte i mendimit që në çdo mbledhje të Komisionit të ftohen përfaqësuesit e një institucioni përkatës, për të raportuar se çka është ndërmarr për zbatimin e atyre rekomandimeve.

Lirije Kajtazi dha përgjigje për çështjen e peticionit prej 205 mijë nënshkrimeve, duke konstatuar se i njëjti nuk na ka ardhur fare në Komision.

Ndërsa në lidhje me Propozim-udhëzuesin për shqyrtimin e peticioneve, theksoi se kjo çështje është mbetur që të definohet me Komisionin për Legjislacion dhe me Sekretarinë e Kuvendit, në mënyrë që të jetë në harmoni edhe me Projekt-rregulloren e Kuvendit.

Salihe Mustafa- Tha se do të ishte mirë që t'i përmbahemi rendit të ditës.

Kjo mbledhje po ngjan sikur të jenë në ballafaqim legjislativi dhe ekzekutivi. Ne duhet të diskutojmë së bashku se si të përmbushim planin e punës në mënyrën më të mirë të mundshme, nëse nuk janë proceduar projektligjet nga qeveria, t'i kërkojmë të gjithë së bashku që të procedohen, por jo në këtë formë të debatit çfarë po bëhet tani.

Mexhide Mjaku-Topalli- Tha se sa u përket shqyrtimit të peticioneve secili institucion e ka punën e vet, shpeshherë kemi dëgjuar palët në Komision, kemi bërë rekomandimet, por edhe kemi dërguar Propozim-rekomandime në Kuvend.

Në lidhje me Propozim-udhëzuesin për shqyrtimin e peticioneve, ajo ishte e mendimit që të sjellët në Komision, ta diskutojmë edhe një herë dhe ta votojmë.

Mytaher Haskuka- Tha se a mundemi deri në fund të vitit me parë se çka është bërë me të gjitha ato përfundime që i ka nxjerrë Komisioni për peticione të ndryshme.

Lirije Kajtazi, lidhur me realizimin e vizitave studimore, theksoi se disa herë kemi kërkuar që të bëhen vizita studimore, pasi që një gjë e tillë është e nevojshme, mirëpo deri më tani akoma nuk është realizuar ndonjë.

Sa i përket vizitave në institucionet korrektuese që janë në Plan të Punës së Komisionit, si dhe te kontrolli financiar i Agjencive të Pavarura nuk janë realizuar akoma, por tha se do të realizohen në të ardhmen pasi që dyja këto çështje i cilësoi si shumë të rëndësishme.

Po ashtu ajo tha se duhet të organizojnë dëgjim publik lidhur me zbatimin e rekomandimeve të nxjerra nga Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit.

Ajo e përmendi edhe mbajtjen e një dëgjimi publik lidhur me shqyrtimin e realizimit të rekomandimeve që kanë të bëjnë me monitorimin e Ligjit për personat e verbër.

Lidhur me nevojën e marrjes së nismës për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për personat e zhdukur, ajo tha se kjo duhet të bëhet, mirëpo paraprakisht duhet që të realizohen takime me Komisionin qeveritar për personat e zhdukur, me qëllim të evidentimit të problemeve rreth zbatimit të ligjit aktual e më pas të ndërmerren hapat e nevojshëm nga ana e Komisionit.

Rreth çështjes së Propozim-udhëzuesin për shqyrtimin e peticioneve, ajo tha se duhet që të caktohet një grup trepalësh me qëllim të sqarimit të kësaj çështje ndërmjet administratës së Kuvendit, stafit të Komisionit si dhe anëtarëve të Komisionit.

Teuta Haxhiu, lidhur me çështjen e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për personat e zhdukur, thekso se do të jetë e rëndësishme që kjo nismë të bëhet para datës 27 prill 2017.

Lirije Kajtazi konstatoi se pikat e parealizuara të Planit të Punës të barten në pjesën e dytë e vitit në mënyrë që të realizohen brenda kësaj periudhe.

Pas këtyre propozimeve anëtarët e Komisionit unanimisht u pajtuan për t'i inkorporuar këto ndryshime në Planin e Punës për sesionin vjeshtor të vitit 2016.

3. Kërkesa për bordin e AKP-së lidhur me çështjen e ish punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore “Sharr-Sallonit” nga Hani i Elezit

Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës Komisioni Funkcional vendosi që të ftojë përfaqësuesit Bordit të AKP-së, më 30 shtator 2016, në orën 13:00.

4. Të ndryshme

Lirije Kajtazi, i informoi anëtarët e Komisionit se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ERA – LGBTI, Equal Rights Association, për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë do të organizojnë Konferencën e Parë rajonale të ERA's “Përse ligjet nuk mjaftojnë”, drejt përfshirjes sociale dhe barazisë së personave LGBTI, në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, i cili do të zhvillohet në Prishtinë më 6-8 tetor 2016.

Ajo theksoi se konferenca do të mbahet në sallën alternative e Kuvendit N-409, më 6 tetor 2016, duke filluar prej orës 08:30-18:00.

Komisioni Funkcional, rreth petitionit të çështjes së fshatit Hade e Re, vendosi që t'i drejtohen me shkrim, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe Komunës së Obiliqit, në mënyrë që të identifikohet gjendja aktuale rreth kërkesës së banorëve të këtij fshati.

Teuta Haxhiu, ishte e mendimit që të caktohet një ditë e veçantë në të cilën do të mbahen mbledhjet e Komisionit dhe kërkoi mendimin e anëtarëve të Komisionit për ditën që do të caktojnë të mbajnë mbledhjet e Komisionit.

Lirije Kajtazi, lidhur me këtë çështje, theksoi se është e vështirë të realizohet në praktikë, sepse agjendat e anëtarëve mund të ndryshojnë dhe do të jetë më e vështirë që t'i përmbahemi.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 15:00.

Kryetarja e Komisionit,

Lirije KAJTAZI

*Procesverbalin e hartoi:
Stafi mbështetës i Komisionit*